

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5495
E mërkurë, 6 qershor 2018
çmimi 0.40 €

Ambasadori i Shqipërisë
në Maqedoni, Fatos
Reka, viziton firmën
"Vatani" në Gjilan

FAQE 12



FAQE 4-5

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**DO TË BËJMË
KOMPROMIS PËR
KOSOVËN, POR
ASKUJT NUK I
TREGOJMË
CILAT JANË ATO**

F. 11



BEHXHET SH. SHALA - BAJGORA

**KOMUNA E MALISHEVËS
BËHET ME ZONË EKONOMIKE**

F. 3

**ISH-KRYEMINISTRI ITALIAN:
ËSHTË KOHA QË I TËRË
RAJONI TË LËVIZË
DREJT BE-së**

F. 6

EKONOMI

**BEQAJ THOTË SE PRIZRENI
DO TË BËHET ME QENDËR
RAJONALE PËR INOVACION**

F. 9

KULTURË

**SOT NË KLINË FILLON
FESTIVALI 'I KËNDOJMË
LIRISË'**

F. 10

SPORT



**PARAQITJE E MIRË E
GJIMNASTEVE NË ITALI**

F. 18

KRYEMINISTRI I KOSOVËS, RAMUSH HARADINAJ,
KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE

Mungesa e konsensusit politik tërheq nga Kuvendi platformën për dialog

Ndonëse ishte paraparë që deputetët e Kuvendit të Kosovës të martën ta shqyrtojnë platformën shtetërore për dialog me Serbinë, një gjë e tillë nuk ka ndodhur, pasi që Qeveria e ka

tërhequr nga rendi i ditës. Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se platforma për dialog është tërhequr nga Kuvendi me qëllim që të gjendet

formula e një përfaqësimi gjithëpërfshirës në këtë temë kaq të rëndësishme. Ai ka paralajmëruar se po të jetë e nevojshme platforma mund të rikthehet në Kuvend



Braktisja e seancave parlamentare për aktivitete partiake nga zyrtarët e lartë shtetërorë është vlerësuar papërgjegjësi e

Analistët: Interesi partiak po vendoset mbi atë shtetëror

madhe nga analistët politikë. Imer Mushkolaj dhe Albert Krasniqi kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se me këto veprime kryeparlamentari, kryeministri, deputetët dhe ministrat po e vendosin interesin partiak mbi atë shtetëror.

Njohësit e rrethanave politike kanë bërë me dije se braktisja e punës në Kuvend dhe mobilizimi i strukturave partiake siç po ndodh së fundi, mund të shihen edhe si përgatitje e partive politike për zgjedhje të reja parlamentare

FAQE 4-5

Soltes në Kosovë mbledh fakte për procesin integruar

Raportuesi i Parlamentit Evropian për Kosovën, Igor Soltes, po qëndron për vizitë në Kosovë. Gjatë takimit me përfaqësuesit e

institucioneve të Kosovës ka thënë se Kosova nuk duhet të lejojë që korrupsioni ta pengojë përparimin e procesit integruar

FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vuçiçi: Dërgimi i ushtrisë në Kosovë, konflikt me NATO-n

BEOGRAD, 5 QERSHOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiçi, tha se NATO-ja e ka paralajmëruar atë kundër ndërhyrjes me Ushtrinë serbe në Kosovë. "Disa herë kam marrë këtë paralajmërim, për të mos përdorur fjalë më të rëndë: Nëse përpiqeni të hyni me ushtrinë tuaj, me policinë tuaj në Kosovë, në çfarëdo mënyre, NATO-ja do ta trajtonte këtë si akt armiqësor dhe do të ishit në konflikt me aleancën më të

fuqishme në botë", tha Vuçiçi. Ai, po ashtu, tha se nuk është optimist për bisedimet me Kosovën, porse Beogradi nuk do të heqë dorë nga dialogu, pasi atë e sheh si "të vetmen zgjidhje drejt kompromisit". "Para nesh janë bisedimet në Bruksel. Nuk jam optimist, por serbët do të bëjnë përpjekje të arrihet deri te kompromisi", u tha Vuçiçi gazetarëve në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Serbisë, raporton

Shërbimi i Ballkanit i "Radios Evropë e Lirë".

Vuçiçi shprehu shqetësim për, siç tha, sulmet e shpeshta ndaj serbëve në Kosovë në ditët e fundit dhe shtoi se kjo është "fushatë për frikësimin e popullatës lokale serbe". "Deri tash kemi arritur ta ruajmë paqen dhe qëndrueshmërinë, por kjo po bëhet gjithnjë e më e vështirë sepse shqiptarët po bëhen gjithnjë e më nervozë", tha Vuçiçi.



Zaevi fton Ivanovin ta dekretojë Ligjin e gjuhës shqipe

Ligji për gjuhët me të cilët avancohet përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe është miratuar më 14 mars, por presidenti maqedonas refuzon ta dekretojë. Kryeministri Zaev edhe një herë i ka bërë thirrje presidentit Ivanov ta dekretojë Ligjin për gjuhët

Shkup, 5 qershor - Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, i ka bërë thirrje presidentit të shtetit, Gjorge Ivanov, ta dekretojë Ligjin për gjuhët dhe të mundësojë funksionimin e papenguar të demokracisë në shoqëri. Ligji për gjuhët me të cilët avancohet përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe është miratuar më 14 mars, por presidenti Ivanov refuzon të dekretojë me arsyetimin se ai është antikushtetues. "Me këtë ai dërgon mesazhin se presidenti mund të vendosë sipas dëshirës së tij për dekretimin e ligjeve. Kjo nuk është demokraci funksionale. Përgjegjësia është më e madhe", ka deklaruar kryeministri Zaev. Ai tha se presidenti duhet ta vendosë nënshkrimin e tij në ligjin e

miratuar, ndërsa për përmbajtjen e ligjit mund të prononcohen institucionet kompetente si Gjykata Kushtetuese, por edhe Komisioni i Venedikut.

Polemikat lidhur me Ligjin për gjuhët po zgjasin tani një vit, apo nga formimi i qeverisë që drejtohet nga social-demokrati, Zoran Zaev, i cili gjatë fushatës elektorale kishte premtuar mbylljen e problemit me gjuhën shqipe.

Zgjidhja që parasheh avancimin apo përdorimin e gjuhës shqipe në të gjitha institucionet shtetërore kundërshtohet nga presidenti Ivanov dhe VMRO DPMNE-ja opozitare e cila edhe organizoi protesta të shumta që u përshkallëzuan edhe në dhunë në Kuvend.



Opozita thotë se me këtë ligj në Maqedoni, zyrtare bëhen dy gjuhë, gjë që bie ndesh me Kushtetutën e cila si gjuhë të vetme zyrtare njeh gjuhën maqedonase. Në bazë të zgjid-

hjes ligjore të miratuar, përdorimi i gjuhës shqipe rregullohet me termin si gjuhë të cilën e flasin mbi 20 për qind nga numri i përgjithshëm i popullatës në Maqedoni.

Opozita shqiptare thotë se me këtë ligj nuk zyrtarizohet gjuha shqipe, siç pretendon BDI-ja në pushtet, por vetëm se avancohet në krahasim me zgjidhjet e deritanishme ligjore.

Bushati: Japonia, rol të shtuar në Ballkanin Perëndimor

TIRANË, 5 QERSHOR - Në ditën e dytë të vizitës së tij në Tokio të Japonisë, ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Ditmir Bushati, është takuar me homologun japonez Taro Kono. Në deklaratën e përbashkët për shtyp që i parapriu takimit dypalësh, ministrat Bushati dhe Kono shprehën vlerësimin maksimal për ecurinë e marrëdhënieve dypalëshe mes dy vendeve që nga vizita e parë e ministrit Bushati në Tokio në 2015-n, të cilat janë kurorëzuar me hapjen e Ambasadës japoneze në Tiranë në fillim të 2017-s. "Jam i lumtur të konstatoj rritje të interesit të kompanive japoneze për të investuar në

Shqipëri. Kjo do të kontribuojë edhe në zhvillim lokal të vendit. Japonia është e gatshme t'i ndihmojë të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre të reformave drejt anëtarësimit në BE, edhe në kuadër të Nismës së Ballkanit Perëndimor të lansuar nga kryeministri japonez në fillim të këtij viti, gjatë turit të tij në Evropën Juglindore dhe Ballkan", tha ministri Kono.

Ministri Bushati nga ana e tij e konsideroi çeljen e Ambasadës së Japonisë në Tiranë si shprehje të vullnetit politik të Qeverisë japoneze për forcimin e marrëdhënieve me Shqipërinë. Ai falënderoi Qeverinë japoneze për

bashkëpunimin e deritanishëm, si një nga mbështetësit më të rëndësishëm të vendit në 27 vjetët e fundit nëpërmjet projekteve konkrete për zhvillimin e reformave shtetndërtuese dhe ekonomike. "Ka ardhur momenti që marrëdhëniet ekonomike të zhvillohen në një stad të ri, ashtu si edhe ato në fushën e turizmit, edukimit dhe kontakteve mes njerëzve".

Në vijim, duke u fokusuar tek Nisma e Bashkëpunimit me Ballkanin Perëndimor, ministri Bushati theksoi se "Përmes kësaj nisme Japonia do të kontribuojë në transformimin demokratik dhe zhvillimin ekonomik të

rajonit, përfshirë Shqipërinë, duke pasur parasysh se ajo është partnere e NATO-s, ku ne jemi vend anëtar, por edhe i BE-së. Ekspertiza teknike japoneze është e vlefshme për të gjitha vendet e rajonit", tha ministri Bushati.

Në vijim, dy ministrat shkëmbyen mendime rreth çështjeve që kanë të bëjnë me zhvillimet në rajonet respektive dhe kontekstin aktual të marrëdhënieve shumëpalëshe. Po të martën ministri Bushati zhvilloi një takim në Parlamentin e Japonisë, ku së bashku me delegacionin parlamentar u takua me kryetarin e Grupit Parlamentar të Miqësisë Japoni - Shqipëri, Hiroshi Hase dhe parlamentarë



të tjerë, të cilët kanë luajtur rol kyç në thellimin e marrëdhënieve dypalëshe.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka mbajtur konferencë për medie

Mungesa e konsensusit politik tërheq nga Kuvendi platformën për dialog

Ndonëse ishte paraparë që deputetët e Kuvendit të Kosovës të martën ta shqyrtojnë platformën shtetërore për dialog me Serbinë, një gjë e tillë nuk ka ndodhur, pasi Qeveria e ka tërhequr nga rendi i ditës. Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se platforma për dialog është tërhequr nga Kuvendi me qëllim që të gjendet formula e një përfaqësimi gjithëpërfshirës në këtë temë kaq të rëndësishme.

Ai ka paralajmëruar se po të jetë e nevojshme platforma mund të rikthehet në Kuvend



për dialogun me Serbinë. Mos harroni se është krijuar një perceptim që i gjithë rajoni po ndihmohet, përveç Kosovës", ka thënë presidenti Thaçi. Një ditë më parë tri partitë opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Partia Socialdemokrate (PSD) patën bërë me dije se nuk do ta votojnë platformën shtetërore për dialogun Kosovë - Serbi. Sipas

tyre, platforma për dialog, e prezantuar nga Qeveria në Kuvendin e Kosovës, është e dobët dhe joserioze. Përfaqësuesit e këtyre subjekteve e kanë quajtur gabim në hapa hartimin e kësaj platforme. Projekt-platforma shtetërore për finalizimin e dialogut me Serbinë ka pasur për synim arritjen e marrëveshjes ligjrisht të obligueshme për të dyja palët, që nënkupton njo-

hjen e ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kjo platformë ka paraparë edhe krijimin e një mekanizmi të krijuar nga Kuvendi për ta përfaqësuar Kosovën në dialog, por që procesi i dialogut do të udhëhiqet nga presidenti Hashim Thaçi. Synim kryesor i kësaj platforme ka qenë arritja e një uniteti politik në mes të partive në pushtet dhe atyre në opozitë për procesin e dialogut me Serbinë.


**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Qeveria e Republikës së Kosovës të martën ka tërhequr projekt-platformën për dialogun me Serbinë nga shqyrtimi në Kuvendin e Kosovës. Kjo është bërë me qëllim që subjekteve dhe aktorëve politikë në Kosovë t'u jepet kohë dhe hapësirë në debatin për gjetjen e qasjes më të mirë ndaj kësaj teme. Me këtë rast kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se Kosova ka nevojë për ta gjetur formulën e një përfaqësimi gjithëpërfshirës në këtë temë kaq të rëndësishme. "Për t'i dhënë kohë debatit dhe për të mos krijuar thyerje mes grupeve politike e kemi tërhequr platformën për bisedimet me Serbinë nga shqyrtimi në Kuvendin e Kosovës. Me këtë i japim kohë spektrit politik dhe grupeve parlamentare që të vijnë me idetë dhe propozimet e tyre. Kosova ka nevojë ta gjejë formulën e një përfaqësimi gjithëpërfshirës në këtë temë kaq të rëndësishme", është shprehur Haradinaj në një konferencë me gazetarë, pas mbledhjes së kabinetit qeveritar.

Megjithatë, kryeministri Haradinaj ka paralajmëruar se

po të jetë e nevojshme platforma mund të rikthehet në Kuvend. "Platforma ka pasur për bazë parime dhe aspekte të tjera që e përbëjnë pozicionin e Kosovës në dialog. Një prej tyre është Institucioni i Presidentit si bartës i përgjegjësiwe institucionale në këtë rast. Tani jemi të hapur për propozime që mund të vijnë nga partitë politike dhe shoqëria civile, prandaj nëse lind nevoja, mund ta rikthejmë një platformë; nëse jo, mund të pajtohemi edhe pa platformë, sepse Kosova ka nevojë për gjetjen e konsensusit për mënyrën e paraqitjes në dialogun me Serbinë. Pra, këtë nuk e mendojmë si detyrë ekskluzive të Qeverisë, por edhe të Kuvendit dhe institucioneve të tjera", ka deklaruar Haradinaj. Për procesin e dialogut ka folur të martën edhe presidenti i vendit, Hashim Thaçi, gjatë takimit me raportuesin e Bashkimit Evropian (BE) për Kosovën, Igor Soltes. Ai i ka thënë Soltesit se institucionet e Kosovës janë duke punuar të ndërtojnë konsensus politik për dialogun me Serbinë. "Jemi mirënjohës për përkrahjen e deritashme. Po punojmë që të prodhojmë sa më shumë argumente pozitive edhe për përkrahësit e Kosovës. Jemi duke punuar që të ndërtojmë konsensus politik

Komuna e Malishevës bëhet me zonë ekonomike



PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Qeveria e Kosovës, në mbledhjen mbajtur të martën, ka shqyrtuar kërkesën në pajtim me përfundimet e Kuvendit të Kosovës për ta paraqitur mendimin për Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Automjete. Mendimi i Qeverisë përbëhet nga deklarata e ndikimeve buxhetore, deklarata e përafritimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe opinionin e Ministrisë së Infrastrukturës. Opinioni i Ministrisë së Infrastrukturës nuk e përkrah miratimin e këtij pro-

jektligji për heqjen e kufizimit të vjetërsisë për importimin e veturave, me arsyetimin se, përveç ndikimeve në mjedis, veturat e vjetra kanë ndikim negativ edhe në sigurinë e komunikacionit. Miratimin e Qeverisë e kanë marrë edhe Projektligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Projektligji për Qasje në Dokumente Publike. Edhe vendimi për shpalljen e zonës me interes të veçantë publik dhe ekonomik për realizimin e themelimit të Zonës Ekonomike në Malishevë, në Zonën

Kadastrale Banjë, në Zonën Kadastrale Bellanicë dhe në Zonën Kadastrale Senik, është miratuar nga kabineti qeveritar. Kjo zonë ka një pozitë të mirë gjeografike dhe me mundësi të zhvillimit industrial dhe bujqësor. Plani i veprimtimit për cilësinë e ajrit 2018-2020 është aprovuar nga Qeveria e Kosovës. Plani synon zhvillimin dhe zbatimin e instrumenteve të caktuara për ngritjen e cilësisë së jetës duke siguruar bazën e përmirësimit të cilësisë së ajrit.

Njohësit e rrethanave politike kritikojnë braktisjen e seancave të Kuvendit për aktivitete partiake

Analistët:

Interesi partiak po vendoset mbi



Braktisja e seancave parlamentare për aktivitete partiake nga zyrtarët e lartë shtetërorë është vlerësuar papërgjegjësi e madhe nga analistët politikë. Imer Mushkolaj dhe Albert Krasniqi kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se me këto veprime kryeparlamentari, kryeministri, deputetët dhe ministrat po e vendosin interesin partiak mbi atë shtetëror. Njohësit e rrethanave politike kanë bërë me dije se braktisja e punës në Kuvend dhe mobilizimi i strukturave partiake siç po ndodh së fundi, mund të shihen edhe si përgatitje e partive politike për zgjedhje të reja parlamentare

Mobilizimi i strukturave partiake, shenjë për zgjedhje të reja

Analistët politikë kanë bërë me dije se braktisja e punës në Kuvend dhe mobilizimi i strukturave partiake mund të shihet edhe si përgatitje për zgjedhje të reja. Sipas Imer Mushkolaj, nuk janë të rastësishme mobilizimet e partive në pushtet. "Aktivitetet e tyre mund të kuptohen edhe ashtu, sepse nuk është i rastësishëm momenti pse ata tash po ndër marrin veprime të tilla. Duke qenë në pushtet ata dëshirojnë t'i mobilizojnë edhe më shumë strukturat e veta partiake në mënyrë që të jenë të gatshëm. Pra, është një mobilizim që u shkon në funksion të liderëve të partive dhe jo rastësisht e kanë zgjedhur këtë moment që t'i mbajnë aktivitetet e tyre partiake", ka thënë Mushkolaj. As analisti tjetër politik, Albert Krasniqi, nuk e ka përjashtuar mundësinë që partitë në pushtet mund ta kenë ndonjë

plan të fshehtë për zgjedhje të reja. "Tani është vështirë të parashihet, sepse partitë politike veprojnë kur ndihen të kërcënuara dhe kështu provokojnë zgjedhje të parakohshme. Së fundi një mobilizim është parë te Nisma për Kosovën dhe PDK-ja. Mirëpo, kjo besoj ka të bëjë më shumë me një aktivitet të Nismës e cila po i mobilizon votuesit dhe po i hyn në terren PDK-së. Pra, ka votues të PDK-së që po kalojnë në Nisma për Kosovën dhe për të mos lejuar humbje të votuesve, PDK-ja është dashur të angazhohet dhe t'i ndalë këto humbje. Këtë po e shoh më shumë në këtë drejtim, mirëpo nuk përjashtohet edhe mundësia që ato të kenë plane të fshehta për zgjedhje të parakohshme", është shprehur ai, duke përmendur edhe faktorët e tjerë që i nxisin subjektet politike

për zgjedhje të reja. "Duke e parë edhe këtë destabilitet të qeverisë, e shohin si një mundësi që t'i mobilizojnë votuesit e tyre dhe në rast se shkohet në zgjedhje të parakohshme, të këtë një avantazh në raport me partitë e tjera opozitare", ka thënë Krasniqi.

Në këtë legjislaturë jo rralëherë ka ndodhur që gjatë seancave parlamentare ulëset e kabinetit qeveritar të jenë të boshatisura dhe në këtë mënyrë shumë pyetje të deputetëve drejtuar anëtarëve të kabinetit kanë mbetur pa përgjigje. As deputetët nuk kanë qenë aq të përgjegjshëm, ku shpeshherë është dashur të shtyhen votimet apo të ndërpriten punimet e Kuvendit në mungesë të kuorumit. Edhe kryeparlamentari dhe kryeministri kanë munguar shpesh në seanca plenare.

EPOKA E RE **Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Njohësit e rrethanave politike në vend kanë kritikuar veprimet e kryeparlamentarit, kryeministrit, ministrave dhe deputetëve, të cilët po i braktisin seancat plenare të Kuvendit për aktivitete partiake. Imer Mushkolaj dhe Albert Krasniqi kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se këto janë veprime të papërgjegjshme të tyre. Sipas

analistëve, me këto veprime zyrtarët e lartë shtetërorë po e vendosin interesin partiak para atij shtetëror. "Largimi nga seancat plenare janë veprime totalisht të papërgjegjshme. Në vend se ta kryejnë punën shtetërore për të cilën paguhen, ata merren me çështje të tjera. Sidomos ditët e fundit janë dhënë shumë pas aktiviteteve partiake kryeparlamentari dhe kryeministri. Kjo tregon një qasje totalisht të papërgjegjshme karshi

Kuvendit të Kosovës në këtë rast, po edhe karshi institucioneve të tjera të vendit, ku

partinë e vendosin përpara shtetit. Fatkeqësisht, nuk është hera e parë që ndodh

kështu, sepse liderët çdoherë interesin partiak e vendosin para interesit shtetëror", ka

atë shtetëror



thënë analisti Imer Mushkolaj. Sipas tij, Kuvendi i Kosovës në këtë kohë do të duhej të ishte më i përgjegjshëm dhe dinamik. "Veçanërisht kryeparlamentari duhet të ketë parasysh se është udhëheqës i një institucioni, i cili është treguar totalisht i papërgjegjshëm prej fillimit të kësaj legjislature. Ai në vend se të jetë motori që do ta vë në lëvizje parlamentin dhe t'i ndëshkojë deputetët që mungojnë në seanca, ai po jep shembull të keq. Kjo nuk do të duhej të ndodhte sidomos në këtë kohë kur vendimet e parlamentit janë jashtëzakonisht të rëndësishme për procesin e liberalizimit të vizave duke vazhduar edhe me proceset e tjera", ka thënë ai.

Edhe monitoruesi i punës së Kuvendit nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Albert Krasniqi, është shprehur kritik ndaj veprimeve të zyrtarëve të lartë në Kuvendin e Kosovës. "Së pari, problemi është se Kuvendi nuk po i organizon mirë punët e veta dhe nuk po përcakton shumë më herët seancat plenare, në bazë të një plani të rregullt të punës, të cilin do të duhej ta

kishte paraprakisht Kryesia e Kuvendit. Nëse seancat do të dihejshin më herët kjo do t'i ndihmonte deputetët dhe ministrat të bëjnë një planifikim më të mirë të punëve dhe angazhimeve që kanë në punët e tyre të përditshme. Mirëpo, kjo nuk e përjashton atë se ne kemi deputetë dhe ministra të papërgjegjshëm, të cilët u ikin punëve që kanë të bëjnë me parlamentin, duke marrë pjesë kështu në aktivitete të cilat kanë për qëllim promovimin e punës së ministrave të caktuar, apo edhe të aktiviteteve të partive politike", ka thënë Krasniqi për gazetën "Epoka e re".

Sipas tij, me këto veprime ata po tregojnë se mobilizimi i strukturave partiake është më i rëndësishëm sesa punët shtetërore, të cilat kanë për obligim t'i kryejnë. "Kohët e fundit kemi parë që partitë politike, sidomos ato pushtet, kanë bërë një mobilizim me strukturat e tyre partiake. Në këtë mënyrë po shihet se vota për ta dhe mobilizimi i votuesit është më i rëndësishëm sesa punët që i kanë për obligim t'i kryejnë në parlament dhe për të cilat janë mandatarë", ka thënë Krasniqi.

Soltes në Kosovë mbledh fakte për procesin integruar

Raportuesi i Parlamentit Evropian për Kosovën, Igor Soltes, po qëndron për vizitë në Kosovë. Gjatë takimit me përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës ka thënë se Kosova nuk duhet të lejojë që korrupsioni ta pengojë përparimin e procesit integruar

**EPOKA
ERE**

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Raportuesi i Parlamentit Evropian për Kosovën, Igor Soltes, ka ardhur për vizitë në Kosovë. Qëllimi i vizitës së tij në Kosovë është të mbledhë sa më shumë të dhëna për zbatimin e agjendës evropiane të Kosovës. "Për këtë jemi në Kosovë, që të mbledhim sa më shumë të dhëna nga udhëheqësit e institucioneve të Kosovës, në mënyrë që të raportojmë në Parlamentin Evropian", u shpreh Soltes gjatë takimit me presidentin Hashim Thaçi.

Ky i fundit e ka falënderuar raportuesin e BE-së për përkrahjen e deritashme. "Jemi mirënjohës për përkrahjen e deritashme. Po punojmë që të prodhojmë sa më shumë argumente pozitive edhe për përkrahësit e Kosovës. Jemi duke punuar të

ndërtojme konsensus politik për dialogun me Serbinë. Mos harroni se është krijuar një perceptim që i gjithë rajoni po ndihmohet, përpos Kosovës", ka thënë presidenti Thaçi. Ai ka theksuar se në Samitin e Sofjes është bërë e qartë që shtetet e Ballkanit Perëndimor duhet të ndërtojnë marrëdhënie evropiane ndërfqinjësore nëse dëshirojnë të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian.

Raportuesi i Parlamentit Evropian për Kosovën, Igor Soltes, është takuar të martën edhe me ministren e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, me të cilën ka diskutuar rreth liberalizimit të vizave dhe përmbushjes së kriterëve që dalin nga ky proces.

Soltes ka ritheksuar se Kosova nuk duhet të lejojë që korrupsioni ta pengojë përparimin e procesit integruar. Ai ka vënë në dukje se lufta kundër krimit të organizuar dhe korrup-

sionit është prioritet për BE-në, sidomos kur është fjala për luftimin e korrupsionit në nivel të lartë, Kosova duhet të vazhdojë të tregojë rezultate. Ministria Hoxha ka thënë se të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave janë plotësuar. Në këtë kontekst, ajo ka thënë se në këtë muaj presin sinjalet e fuqishme për zbatimin në tërësi të këtyre kushteve në mënyrë që të mund të ecë tutje procesi i liberalizimit të vizave. "Ne jemi të vetëdijshëm se luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit nuk është i lidhur me afate, andaj konsiderojmë se edhe pas heqjes së regjimit të vizave për Kosovën, institucionet vendore nuk do ta ndalin luftimin e këtyre dukurive", ka theksuar ministrja Hoxha, duke shtuar se qytetarët e Kosovës presin që progresi i Kosovës të vlerësohet nga institucionet e Bashkimit Evropian.



Kosova përfiton nga Luksemburgu projekte në vlerë dy milionë euro

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, mori pjesë në ceremoninë e lansimit të projektit të bashkëpunimit me Luksemburgun, për asistencë teknike në kontekst të integritimit evropian, 2018-2022, ku morën pjesë e ngarkuara me punë e Ambasadës së Luksemburgut, Anne Dostert dhe ambasadori i Norvegjisë, Per Strand Sjaastad, si dhe zyrtarë të lartë të BE-së. Ministria Hoxha ka vënë në pah se është rritur angazhimi në zbatimin e Agjendës së Reformave Evropiane dhe Programit Kombëtar për MSA-në. "Qëllimi është zbatim i MSA-së në veçanti dhe agjendës së integritimit në përgjithësi në mënyrë që të jemi të gatshëm për fazat e ardhshme të integritimit. Gjithashtu, synohet edhe forcimi i komunikimit duke mbështetur

zbatimin e strategjisë sonë për komunikim dhe informim të procesit të integritimit", ka thënë ministria Hoxha. Ajo ka thënë se marrëveshja e bashkëpunimit në kontekst të integritimit evropian me Luksemburgun për mbështetje institucionale të Kosovës për ndërtimin e kapaciteteve për zbatimin e MSA-së në fusha prioritare është dy milionë euro për katër vjet, me 100 000 euro bashkëfinansim nga Kosova. Mbështetje të ngjashme për nëntë fusha të tjera Kosova është duke diskutuar me Norvegjinë. Përfitues do të jetë jo vetëm Ministria e Integritimit, por edhe institucionet e tjera të vendit. "Për ministrinë tonë kjo iniciativë ka rëndësi të veçantë pasi për herë të parë implementimi bëhet nga Ministria e Integritimit përmes një mekanizmi për kapacitete dhe natyrisht me ndihmën e Agjencisë për Zhvillim të Luksemburgut dhe Ambasadës Norvegjeze në Kosovë. Pra,



përveç forcimit të kapaciteteve për zbatim të MSA-së, mekanizmi do të ndikojë pozitivisht edhe në forcimin e kapaciteteve tona për menaxhim të fondeve dhe projekteve", ka thënë Hoxha. Ministria Hoxha ka falënderuar Qeverinë e Luksemburgut, Agjencinë për Zhvillim të

Luksemburgut si dhe Norvegjinë për mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre. Njëkohësisht, i ka ftuar institucionet e Kosovës për mbështetje dhe angazhim në zbatimin me sukses të projektit në katër vjetet e ardhshëm. Ndërsa e ngarkuara me punë e Ambasadës së

Luksemburgut, Anne Dostert dhe ambasadori i Norvegjisë, Per Strand Sjaastad, kanë theksuar se përkrahja e Kosovës nga ana e tyre në procesin integruar nuk do të mungojë, duke vënë në dukje rëndësinë e zbatimit të MSA-së dhe Agjendën Evropiane të Reformave.

Ismaili paralajmëron rritje të pagave për profesionistët shëndetësorë



PRISHTINË, 5 QERSHOR - Ministri i Shëndetësisë (MSH), Uran Ismaili, ka bërë me dije të martën se do të rriten pagat për të gjithë profesionistët shëndetësorë. Ismaili gjatë adresimit të tij në Kuvendin e Kosovës ka thënë se tashmë janë marrë të gjitha hapat nga Ministria e Shëndetësisë që të rriten pagat për këtë kategori. Ministri Ismaili ka theksuar se tashmë është përgatitur edhe konceptdokumenti i cili i është dërguar Ministrisë së Administratës Publike. "Pagat do të rriten për të gjithë profe-

sionistët shëndetësorë. Ne tashmë kemi marrë të gjitha hapat e nevojshme dhe të gjitha dokumentet i kemi dërguar në Ministrinë e Administratës Publike. Çka është më e rëndësishmja, për herë të parë profesionistët shëndetësorë do të kenë këso rritje të pagave dhe kthim të dinjitetit të tyre", ka thënë ministri Ismaili. Po ashtu, ministri Ismaili ka bërë me dije se në listën e pagave do të hyjnë qindra specialistë, si dhe do të punësohen 90 mjekë specialistë dhe 141 infermierë.

Haradinaj e priti në takim Menduh Thaçin

PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka pritur të martën në takim kryetarin e Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), Menduh Thaçi, me të cilin ka biseduar për zhvillimet politike dhe tema të tjera të rëndësishme për të dy vendet. Me këtë rast Haradinaj ka përshëndetur rekomandimin për hapjen e negociatave për Maqedoninë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, duke theksuar se kjo është e rëndësishme për perspektivën evropiane të rajonit. Kryeministri e ka njoftuar Thaçin për të arriturat në Kosovë, për rrugën integruarë të Kosovës në BE dhe në NATO, duke theksuar se përkrahja e

Maqedonisë në këto procese është e nevojshme për Kosovën. "Kosova dhe Maqedonia janë shembull se si dy shtete fqinje tregojnë marrëdhënie të mira dhe partneritet të mirë ekonomik dhe politik dhe ky shembull duhet të shërbejë edhe për vendet e tjera të rajonit, në mënyrë që në Ballkan të ketë paqe të qëndrueshme", është shprehur Haradinaj. Kryetari i PDSH-së, Menduh Thaçi, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për pritjen dhe angazhimin për marrëdhënie të mira bilaterale mes dy vendeve, duke theksuar mundësinë e thellimit të raporteve në të gjitha fushat e interesit të përbashkët.



Ish-kryeministri italian: Është koha që i tërë rajoni të lëvizë drejt BE-së

Ish-kryeministri i Italisë, Massimo D'Alema, ka takuar të martën në Prishtinë përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, me të cilët ka biseduar për bashkëpunimin Itali - Kosovë dhe proceset nëpër të cilat po kalon vendi ynë. D'Alema ka thënë se Kosova ka ecur përpara dhe ka theksuar se është koha që i tërë rajoni të lëvizë drejt BE-së

EPOKA
ERE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Ish-kryeministri i Italisë, Massimo D'Alema, po qëndron për vizitë në Kosovë. Ai gjatë ditës së martë është takuar me përfaqësues të institucioneve të vendit tonë. Në takim me presidentin Hashim Thaçi, ish-kryeministri italian ka thënë se Kosova ka ecur përpara. "Kosova ka ecur përpara. Është koha që i tërë rajoni të lëvizë drejt BE-së", është shprehur D'Alema. Ndërkaq presidenti Thaçi e ka falënderuar ish-kryeministrin italian për angazhimin e tij për Kosovën dhe rajonin. "Faleminderit për angazhimin tuaj personal, për përkrahjen për

Kosovën dhe rajonin. Do të jemi mirënjohës përgjithmonë", ka thënë presidenti Thaçi.

Presidenti Thaçi dhe ish-kryeministri italian kanë folur edhe për rëndësinë e ndërtimit të marrëdhënieve të mira ndërfaqinësore në Ballkanin Perëndimor, duke përmendur edhe rëndësinë e Samitit të Sofjes si konfirmim i perspektivës evropiane për rajonin tonë.

Ish-kryeministri italian është pritur në takim edhe nga kryeministri Ramush Haradinaj. "Kontributi i Italisë për ta arritur paqen në Kosovë dhe roli i saj i vazhdueshëm për shtetndërtim është i pazëvendësueshëm dhe Kosova është mirënjohëse", kështu ka thënë kryeministri Haradinaj pasi ka pritur në takim ish-kryemi-



nistrin e Italisë, Massimo D'Alema.

Haradinaj e ka informuar ish-kryeministrin D'Alema për të arriturat e Kosovës, prioritetet e Qeverisë, për zhvillimin ekonomik, ndërtimin e marrë-

dhënieve të mira ndërfaqinësore dhe punën që po bën vendi në përaftrim me agjendën evropiane. "Republika e Italisë është prej vendeve mike me të cilën Kosova ka ndërtuar raporte të shkëlqyera bilaterale, ndërsa tani jemi të interesuar t'i forcojmë lidhjet tona edhe në aspektin ekonomik", është shprehur Haradinaj.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se roli i ish-kryeministrin D'Alema për proceset nëpër të cilat ka kaluar Kosova ka qenë shumë i rëndësishëm, duke kërkuar që edhe më tutje ta ushtrojë autoritetin e tij për forcimin e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet dy vendeve dhe për procesin e integriteteve euroatlantike të Kosovës.

Ndërkaq ish-kryeministri i Italisë, Massimo D'Alema, e ka vlerësuar progresin e Kosovës dhe dinamikën qeverisëse të kryeministrin Haradinaj, duke thënë se Italia do të jetë përkrahëse e Kosovës në rrugën e saj euroatlantike. Po ashtu, edhe zëvendëskryeministri i parë, njëherësh ministër i Punëve të

Jashtme, Behgjet Pacolli, ka pritur në takim ish-kryeministrin e Italisë, Massimo D'Alema.

Gjatë këtij takimi Pacolli ka thënë se ende i ka në mendje fjalët që D'Alema ia kishte thënë gjatë varrimit të ish-presidentit Ibrahim Rugova në vitin 2006. "Ende i kam në mendje fjalët tuaja në funeralin e presidentit Rugova. Ai vdiq pa e parë të realizuar ëndrën e vet, Kosovën e çliruar dhe të pavarur", ka thënë Pacolli.

Më tutje, Pacolli ka kujtuar momentet e organizimit të fushatës mediatike kundër pastrimit etnik serb, në vitin 1999 apo dhe ndihmës humanitare për kampet e të shpërngulurve në Shqipëri, në Mal të Zi etj.

Pacolli e D'Alema kanë biseduar për bashkëpunimin e Kosovës me Italinë dhe rrugët e forcimit të këtij bashkëpunimi. Pas takimit në ministrin e Punëve të Jashtme, Pacolli dhe D'Alema kanë përkrahur në këmbë Sheshin "Nënë Tereza". Ish-kryeministri i Italisë, Massimo D'Alema, po qëndron në Kosovë me ftesë të kryediplomatit të Kosovës, Behgjet Pacolli.



Nënshkruhet marrëveshja 'Erasmus+', përfitojnë studentët dhe profesorët

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Të martën në Bruksel ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi dhe komisionari evropian për Edukim, Kulturë, Rini dhe Sport, Tiborn Navracsics, kanë nënshkruar marrëveshjen ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës për pjesëmarrjen e Kosovës në "Erasmus+", programin e unionit për arsim, trajnim rini dhe sport. Kjo marrëveshje hap rrugë për studentët dhe profesorët, institucionet, organizatat dhe individët, të cilët me nënshkrimin e kësaj marrëveshje

janë të barabartë me konkurrenset e tjerë të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Me këtë rast, ministri Bytyqi ka falënderuar komisionarin Navracsics për mundësinë që i ka dhënë Ministrisë së Arsimit për të nënshkruar një marrëveshje kaq të rëndësishme për arsimin në Kosovë, ndërsa ka theksuar se programi "Erasmus+" në Kosovë është i njohur dhe ka pasur praktika të mira deri më tani. "Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje u kemi ofruar mundësi të rinjve tanë, studentëve dhe mësuesve tanë, që të përfitojnë

nga ky program dhe do të ndihmohet forma e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare, e cila është tejet e nevojshme", ka thënë ministri Bytyqi. Ai ka thënë se do të jenë të kujdesshëm që këto tri pika që janë paraparë në këtë program t'i shfrytëzojnë në mënyrë sa më të mirë.

Ministri Bytyqi ka deklaruar se MASHT-i do t'i ndihmojë institucionet tona që sa më mirë t'i shfrytëzojnë këto fonde, ndërsa u shpreh i sigurt se me këtë marrëveshje po i hapet perspektivë ndërkombëtarizimit të arsimit të Kosovës.



Beqaj thotë se Prizreni do të bëhet me qendër rajonale për inovacion

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRIZREN, 5 QERSHOR - Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë përmes aktivitetit "Think Future - Prizren" ka promovuar të martën "Programin për financimin e organizatave joqeveritare" dhe "Parkut të Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren". Në këtë ngjarje kanë marrë pjesë kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, zëvendëskryeministri Enver Hoaxhaj dhe ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj. Në hapje të këtij aktiviteti ministri Beqaj ka folur para të rinjve të Prizrenit për rëndësinë e këtij programi, duke inkurajuar OJQ-të dhe të rinjtë me ide inovative në shërbim të rritjes së kapacitetit të ndërmarrjeve, që të bëhen pjesë e tij. "Programi i financimit të Ministrisë, orienton dhe përkrah inovatorët t'i kombinojnë njohuritë, kapacitetet dhe resurset për ta zhvilluar konceptin e inovacionit brenda ndërmarrjes", ka thënë ministri Beqaj. Ai ka shtuar se Ministria e Inovacionit dhe

Ndërmarrësisë ka në mandat politik dhe strategjik stimulimin e aktiviteteve inovative në Republikën e Kosovës të cilat janë të lidhura ngushtë me ndërmarrësinë. "Investimi në rini është garanci për një të ardhme të ndritur dhe fuqizimit ekonomik të Kosovës", është shprehur Beqaj.

Ministri Beqaj ka folur edhe për hapjen e shpejtë të Parkut të Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren, duke theksuar se Prizreni do të bëhet qendër rajonale për inovacion në Ballkanin Perëndimor. Ndërkaq kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se fusha e teknologjisë informative dhe investimi në inovacione dhe ndërmarrësi do të bëhet prioritet dhe fokus i zhvillimit ekonomik në Republikën e Kosovës. Ai ka thënë se me këtë qëllim është shtyrë përpara themelimi i Ministrisë së Inovacionit.

Kryeparlamentari Veseli ka thënë se Kosova ka rini inovatore me shumë ide dhe energji për punë. Ai ka inkurajuar të gjithë të rinjtë e regjionit të Prizrenit, por edhe të gjitha qyteteve të



tjera që të aplikojnë me idetë e tyre për të marrë mbështetje nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Veseli ka thënë se vitin e ardhshëm do të dyfishohen këto fonde, në mënyrë që të rinjtë e Kosovës me ide inovatore t'i realizojnë idetë dhe projektet e tyre, ndërmjet të

cilave do të krijohen edhe shumë vende të reja pune. "Ne kemi nevojë jo vetëm të hapim vende të reja të punës për të rinjtë tanë, por edhe t'i aftësojmë ata që vetë të jenë krijues të vendeve të punës. Këtu qëndron thelbi i zhvillimit ekonomik. Në duhet të lëvizim në këtë drejtim

dhe ky është vizioni im. Unë do të jem në përkrahje të plotë të të gjithë atyre që kanë iniciativa zhvillimore. Duke i përkrahur ata ne e ndihmojmë ecjen përpara të vendit tonë. Iniciativa e lirë e ka ndryshuar botën. Ajo do ta ndryshojë edhe Kosovën", ka thënë Veseli.

Ambasadori francez i sugjeron Hamzës të përmbahen nga shpenzimet e reja

PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Francës në Kosovë, Didier Chabert, me të cilin ka diskutuar për progresin dhe sfidat e vendit tonë në fushën e financave dhe ekonomisë. Me këtë rast, ministri Bedri Hamza ka falënderuar ambasadorin Chabert për mbështetjen që shteti francez i ka dhënë Kosovës deri më tani përmes projekteve të cilat ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të vendit si dhe në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Hamza e ka njoftuar ambasadorin francez për procesin e të hyrave buxhetore, për masat e reja fiskale, për

planin e adresimit të sfidave në fushën e ekonomisë, për ruajtjen e rritjes ekonomike dhe indikatorëve makrofikale, për përkushtimin në fuqizimin e sektorit privat si bartës të rritjes ekonomike në vend, si dhe përkushtimin e Ministrisë së Financave në luftimin e informalitetit.

Ndërkaq ambasadori i Francës në Kosovë, Didier Chabert, ka falënderuar ministrin Hamza për pritjen dhe ka shprehur mbështetjen e tij të plotë për përpjekjet e bëra për të arritur një rritje të të hyrave buxhetore prej 10 përqindësh krahasuar me vitin e kaluar dhe për t'u përmbajtur nga shpenzimet e reja që mund të ndikojnë në afat të gjatë në qëndrueshmërinë buxhetore.



Gjini paraqiti të arriturat e gjashtë muajve të parë të qeverisjes

GJAKOVË, 5 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, bashkë me drejtorët e drejtorive komunale, të martën ka mbajtur debatin e parë publik, me ç'rast para qytetarëve të mbledhur ka paraqitur të arriturat e gjashtë muajve të parë të qeverisjes lokale si dhe ka shpalosur të gjitha idetë dhe projektet që presin të realizo-

hen gradualisht në periudhat e ardhshme.

Gjini fillimisht ka folur për problemet në infrastrukturë, kryesisht rrugore, probleme të cilat në masë të madhe janë përmendur edhe nga qytetarët. Lidhur me këtë çështje, kryetari Gjini ka thënë se komuna ka qëllim që deri në fund të këtij mandati të gjitha rrugët dhe rrugicat në tërë territorin e komunës

të jenë të përfunduara. Gjini ka folur edhe për sektorët e arsimit dhe atë të zhvillimit ekonomik, si dy sektorë me prioritet afatgjatë për qeverisjen lokale.

Në këtë temë kryetari Gjini ka përmendur themelimin e Këshillit Konsultativ të Arsimit si dhe Këshillit të Partneritetit Publiko-Privat, organizma që do të ndikojnë në përmirësimin afatgjatë të

arsimit, respektivisht do të ndikojnë në rritjen e zhvillimit ekonomik lokal. Në temën e zhvillimit ekonomik kryetar Gjini ka përmendur edhe funksionalizimin e zonës industriale, për të cilën tashmë ekziston edhe premtimi konkret i Qeverisë së Kosovës.

Gjatë debatit ka pasur edhe shumë pyetje nga qytetarët e pranishëm, të cilave u janë

përgjigjur me përgjigje konkrete kryetari Gjini dhe drejtorët e drejtorive komunale. Përveç pyetjeve, qytetarët kanë pasur edhe komentet e tyre për qeverisjen e deritashme, e cila në tërësi është vlerësuar pozitivisht dhe në shërbim të plotë të qytetarëve. Debatit i dytë publik parashihet të mbahet në dhjetor të këtij viti.

Hasani: MTI-ja ka përmbushur detyrimet e dala nga agjenda evropiane

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Bajram Hasani, ka thënë se është shënuar progres në përmbushjen e detyrave që dalin nga agjenda evropiane sa i përket ministrisë që drejton. "Ne kemi bërë shumë punë për përafrimin e legjislacionit me BE-në. Disa janë koncept dokumente, disa janë në lexim të parë dhe disa janë në përfundim", ka theksuar ministri Hasani gjatë raportimit para anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Integritime Evropiane

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Bajram Hasani, ka raportuar të martën para anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Integritime Evropiane për zbatimin e Programit kombëtar për zbatimin e MSA-së. Hasani ka thënë se MTI-ja është ndër institucionet e vetme që ka përmbushur shumicën e rekomandimeve që dalin nga raporti i progresit të Komisionit Evropian. "Ne kemi bërë shumë punë në përafrimin e legjislacionit me BE-në. Disa janë koncept dokumente, disa janë në lexim të parë dhe disa janë në përfundim", ka theksuar min-

istri Hasani. Ndër të tjera, në këtë mbledhje është diskutuar për cilësinë e naftës në Kosovë, për numrin e inspektorateve, për misionin e konkurrencës, për lëvizjen e lirë të mallrave, për doganat dhe për favorizimin e prodhuesve vendorë.

Sa iu përket rezervave buxhetore dhe kompetencave të trupave inspektues të cilësisë së naftës, ministri Hasani ka pohuar se kjo çështje kap kosto të lartë buxhetore dhe mund të marrë kohë deri në finalizim.

Hasani ka folur edhe për Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, me ç'rast ka thënë se vetëm përmes sistemit "online" janë regjistruar deri më tani 46 biznese. Ai ka bërë me dije se shumë shpejt do të hyjë në

funkcion dhe softueri i ri sa i përket unifikimit të numrit të bizneseve. "Shumë shpejt do të fillojmë me softuerin e ri për unifikim të numrit të bizneseve që do t'ua lehtësojë punën bizneseve. Presim shumë shpejt të ketë lehtësira edhe në sistemin 'online'. Janë regjistruar 46 biznese", ka thënë Hasani

Kurse anëtari i këtij komisioni nga radhët e PDK-së, Zenun Pajaziti, e ka përgëzuar ministrin Hasani për angazhimin e

treguar deri më tani. Pavarësisht prej kësaj, Pajaziti kishte vërejtje te rezervat e naftës, ku ka kërkuar nga ministri Hasani të deklarohet për një zgjidhje të mundshme. Me këtë rast, ministri Hasani ka përsëritur qëndrimin e tij se kjo çështje ka kosto të lartë buxhetore. Ai ka thënë se për shkak të implikimeve financiare ende nuk kanë ndonjë opinion përfundimtar lidhur me çështjen e rezervave të naftës. Po ashtu,

ministri Hasani ka paralajmëruar masa të reja mbrojtëse për prodhuesit vendorë, reformim të inspektoratit, si dhe të KIESA-s. "Duhet të bëhet reformimi i KIESA-s, kurse sa i përket mbrojtjes së prodhimeve vendore, janë 12 apo 13 raste që jemi duke i shqyrtuar pasi që, përpos ankesës së prodhuesve vendorë, duhet ta verifikojmë një produkt para se t'i vëmë masat mbrojtëse", ka thënë Hasani.

Tajvani, mundësi për plasimin e produkteve 'Made in Kosova'

PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, ka pritur në një takim miqësor një delegacion të Zyrës Përfaqësuese të Tajvanit për Evropë me seli në Budapest të udhëhequr nga Yun-Ping Andrew Chang me zyrarë të tjerë të kësaj zyre, me qëllim të diskutimit rreth avancimit të bashkëpunimit ekonomik në mes të Kosovës dhe Tajvanit. Gjatë këtij takimi u informuan se Tajvani është duke përgatitur një statut preferencial për prodhimet e Kosovës me qëllim të krijimit të mundësive për eksport në këtë vend, në veçan-

ti për mineralet, prodhimet bujqësore, përpunim të metaleve dhe produkteve të tjera. "Duhet të eliminohen disa barrierat për lëvizjen e bizneseve nga Tajvani në Kosovë sepse ekziston potencial dhe vullnet i pashfrytëzuar për plasim të produkteve të Kosovës, por lëvizja dhe vizitat e bizneseve nga ky shtet mik duhet të lirohen nga procedura burokratike", është thënë në njoftimin e OEK-ut.

Gjithashtu, në këtë takim ishin të pranishme edhe disa biznese të Kosovës të cilat kanë potencial eksporti të produkteve të tyre në këtë treg. "Qëllimi i viz-



itës së këtij delegacioni ishte mundësia e gjetjes së part-

nerëve afaristë nga Kosova për plasimin e produkteve 'Made in

Kosova' në Tajvan si dhe pjesëmarrja në panairë të ndryshme të organizuara goftë në Tajvan. Gjatë qëndrimit të këtij delegacioni janë paraparë vizita të shumë bizneseve të Kosovës në regjione të ndryshme të vendit tonë", thuhet në njoftimin e OEK-ut.

Vitin e kaluar ishte organizuar një vizitë e ngjashme e një delegacioni nga Tajvani në Kosovë, me ç'rast e vizituan edhe panairin e organizuar nga OEK-u, si dhe disa firma të Kosovës. Si rezultat i kësaj vizite ishte realizuar edhe eksporti i produkteve nga kompanitë "Frutex" dhe "Ujë Rugove" në këtë shtet.

Prishtinën për tre muaj e vizituan 29 487 vizitorë



PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Statistikat e Hotelerisë në Kosovë për tremujorin e parë (TM1) 2018. Në tremujorin e parë të vitit 2018 (TM1 2018) pjesë e anketës ishin 187 hotele, që ushtrjnë veprimtari hoteliere në territorin e Kosovës.

Pjesa më e madhe e hoteleve gjenden në rajonin e Prishtinës, Pejës, Prizrenit etj. Sipas anketës,

kapaciteti i shfrytëzuar në nivel vendi ishte 12.38%. "Në TM1 2018 numri i vizitorëve ishte 64 501 vizitorë, prej tyre 42.69% ishin vizitorë vendorë, kurse 57.31% ishin vizitorë të jashtëm. Ndërkaq, numri i bujtjeve në TM1 2018 ishte 86 227 bujtje, ku 40.70% e bujtjeve ishin nga vendorët dhe 59.30% nga të huajt. Numrin më të madh të vizitorëve e ka Rajoni i Prishtinës me 29 487 vizitorë dhe 41 224 netqëndrime. Numri më i

madh i vizitorëve të huaj përqendrohet në Prishtinë, Prizren e kështu me radhë. Sa iu përket vizitorëve të huaj, numri më i madh ishte nga Shqipëria, Turqia, ShBA etj", është thënë në publikimin e ASK-së.

Këtij publikimi i është bashkangjitur edhe një aneks i veçantë, që përmban të dhënat nga Policia e Kosovës lidhur me numrin e vizitorëve të jashtëm sipas pikëkalimeve kufitare gjatë vitit 2017.

Sot në Klinë fillon festivali 'I këndojmë lirisë'

KLINË, 5 QERSHOR (ER) - Sot (e mërkurë) nis festivali folklorik mbarëkombëtar "I këndojmë lirisë", që mbahet më 6, 7 dhe 8 qershor. Sivjet është edicioni 18 me radhë i festivalit dhe nis në Çabiq, në vendlindjen e Mujë Krasniqit - Kapuçit, njërit prej komandantëve më të shquar të UÇK-së. Në hapjen solemne të festivalit para kullës muze, me këngë e valle do të paraqitën grupe artistësh rapsodë e instrumentistë nga Kosova dhe Shqipëria. Ndërkaq, e para që do të paraqitet në skenë është ShKA "Drenica" e Skenderajt, fituese e vitit të kaluar e çmimit kryesor "Mujë Krasniqi". Pastaj do të paraqiten edhe grupe e shoqëri artistike e rapsodë. Në Çabiq do të shtrohet edhe sofrat tradicionale e këtij fshati, ku në nderim të festivalit dhe të bashkëfshatarit e komandant Mujës, do ta shtrojnë sofrën tradicionale me ushqimet tradicionale. Ndërkaq, në qytetin e Klinës gjatë ditës do të zhvillohen edhe aktivitete të tjera. Në Sheshin "Mujë Krasniqi" do të bëhet



parakalimi i shoqërive dhe grupeve artistike, ku do të hedhet vallja dhe do të këndohet për Mujën dhe trima të tjerë të UÇK-së.

Në përmblyllje të festivalit ndahen edhe çmimet kryesore të festivalit.

Çmimi kryesor është ai i Mujë Krasniqi, pastaj vendi i dytë, vendi i tretë, teksti më i mirë i këngës, interpretuesi më i mirë, çmimi i publikut, vallja më e mirë, instrumentisti më i mirë, veterani i festivalit, veshja më autentike e të tjerë. (Enver Maloku)

Mjekët amerikanë vizitojnë Komunën e Skenderajt

PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Organizata joqeveritare "Kosovo Hope", në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Skenderajt, kanë organizuar një vizitë me mjekë amerikanë, të cilët kanë qëndruar në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "Azem Bejta" në Prekaz.

Kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Osman Veliu, kanë takuar mjekët amerikanë për t'i parë nga afër shërbimet që janë duke ua ofruar qytetarëve.

Gjatë vizitës mjekët amerikanë e kanë nderuar Jasharin duke i dhuruar një flamur amerikan si dhe një dhuratë simbolike. Kurse i pari i Skenderajt ka falënderuar për kontributin që ka dhënë Amerika dhe vazhdon të japë në mbështetje të Kosovës. Po ashtu, Jashari i ka nderuar mjekët



amerikanë me dhurata simbolike. Gjatë kësaj vizite mjekët amerikanë kanë vizituar pacientë dhe kanë shpërndarë barna falas. Në këtë grup ishin mjekë të ndryshëm familjarë dhe mjekë për fëmijë. Të drejtë të vizitës kishin të gjithë qytetarët pa dallim dhe të gjitha moshat, si dhe personat që janë në procedurë për trajtim jashtë vendit, për konsulta paraprake.

Me aktivitete të shumta u shënua në Mitrovicë Dita Botërore e Mjedisit

MITROVICË, 5 QERSHOR (ER) - Përfaqësues të Komunës së Mitrovicës dhe institucioneve të tjera komunale, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të kompanive të ndryshme dhe individë të shumtë, kanë marrë pjesë në aktivitetet e organizuara për shënimin e Ditës Botërore të Mjedisit. Në krye të më shumë se 300 pjesëmarrësve (nxënës, studentë, qytetarë, punëtorë të kompanive të ndryshme etj.) ishin kryetari i komunës, Agim Bahtiri, nënkryetari Faruk Mujka, drejtorët e drejtorive komunale, këshilltarja e kuvendit të komunës Valbona Sadiku dhe personalitete të tjera.

Hapësirat që u pastruan gjatë kohës sa zgjati aktiviteti për shënimin e Ditës Botërore të Mjedisit ishin ato përreth



ndërtesës së administratës komunale, sheshet dhe bulevardet kryesore në qendër të qytetit, parku i qytetit nga ura kryesore mbi lumin Ibër deri mbi vigun tek tre rrokaqiejt, hapësira përmes liqenit akumulues në Suhodoll etj.



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Opština Štrpce
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Štrpce



Na osnovu clana 8 Zakona o Radu br.03/L-212 i clana 3 Administrativnog upustva br.14/2011 za regulisanje procedura radnog odnosa u javnom sektoru, Odeljenje za Zdravstvo i Socijalna pitanja, raspisuje sledeci:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Doktor Medicine
Broj pozicije: 1
Odeljenje: Zdravstvo i Socijalna pitanja
Koeficijent: 7,2
Ugovor: 1 godina (mogucnost produzenja, probni period u trajanju od 3 meseca)
Izvestava: Direktor i sefu odeljenja

Opis poslova i odgovornosti:

- Vrsi pružanje zdravstvenih usluga u primarnoj zdravstvenoj zastiti.
- Obavlja redovnu evidenciju medicinske dokumentacije, daje upustve pismeno i usmeno za tretiranje pacijenata.
- Daje savete i upustva medicinskim tehnicarima.
- Vrsi sistematsku kontrolu pacijenata i učenika.
- Vrsi procenu rada osoblja pod nadzorom.
- Vrsi redovnu kontrolu dokumentacije i evidenciju pacijenata.
- Vrsi registraciju, evidenciju razne zarazne bolesti.
- Za svoj rad odgovara Direktor CPM i Opstinskom Odeljenju za Zdravstvo.

Kvalifikacije i radno iskustvo:

- Diploma Medicinskog fakulteta
- Radna licenca
- 1 god. radnog iskustva pozeljno

Vestine i sposobnosti:

- Poznavanje lokalnih jezika
- Dobra komunikacija sa ljudima
- Poznavanje rada na racunaru

Konkurs ostaje otvoren 15 dana nakon objavljivanja na oglasnim tablama u Štrpcu, Drakovcu i medijima. Aplikacije koje su poslate postom i imaju datum poslednjeg dana konkursa, a budu stigle najkasnije 4 dana od dana zavrsetka istog uvazice se kao validne. Aplikacije se mogu uzeti i podneti u opstinskoj zgradi u kancelariji br.51 svakog radnog dana od 9 do 15 casova. Civilna Sluzba Kosova je u sluzbi svih gradjana Kosova i ocekuje aplikacije od oba pola iz svih zajednica na Kosovu.

Direktor odeljenja
Valmir Ahmeti



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Opština Štrpce
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Štrpce



Në bazë të nenin 8 të Ligjit mbi punën nr.03/L-2012, nenit 3 udhëzimit Administrativ nr.14/2011 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpall këtë:

KONKURS

- Titulli i vendit të punës: Mjek
- Numri i pozitave: 1
- Drejtoria: Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale
- Koeficienti: 7,2
- Kontrata: 1 vit (me mundësi vazhdimi, periudha provuese 3 muaj)
- Raporton: Drejtorit dhe Shefit të Drejtorisë

Përshkrimi i punëve dhe përgjegjësitë:

- Bën ofrimin e shërbimeve shëndetësore në mbrojtjen primare shëndetësore.
- Kryen evidencën e rregullt të dokumentacionit mjekësor, jep udhëzime me shkrim dhe me gojë për trajtimin e pacientëve.
- Jep këshilla dhe udhëzime teknikëve medicinal.
- Bën kontrollin sistematik të pacientëve dhe nxënësve.
- Vën vlerësimin e punës së stafit nën mbikqyrje.
- Bën kontrollin e rregullt të dokumentacionit dhe evidentimin e pacientëve.
- Bën regjistrimin, evidentimin e sëmundjeve të ndryshme ngjitëse.
- Për punën e vet i përgjigjet Drejtorit të QMF-së dhe Drejtorisë komunale për Shëndetësi.

Kualifikimet dhe përvoja e punës:

- Diploma e fakultetit të mjeksisë
- Lisenca e punës
- 1 vit përvoj pune e preferueshme

Shkathtësitë dhe aftësitë:

- Njohja e gjuhëve lokale
- Komunikim i mirë me njerëz
- Njohja e punës në kompjuter

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pas publikimit në tabelat e shpalljes në Shtërpçë, Drekoç dhe media. Aplikacionet të cilat janë dërguar me postë dhe kanë datën e njejtë me ditën e fundit të konkursit, kurse arrijnë më së voni 4 ditë nga dita e përfundimit të njëjtit do të konsiderohen si valide.

Aplikacionet mund të merren dhe parashtrihen në ndërtesën komunale në zyrën nr.51 çdo ditë pune prej orës 09 deri në ora 15. Shërvimi Civil i Kosovës është në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mirëpret aplikacione nga të dy gjinitë nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Drejtori i drejtorisë
Valmir Ahmeti

Do të bëjmë kompromis për Kosovën, por askujt nuk i tregojmë cilat janë ato



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Bastardimi i përfaqësimit apo kurvëria e karrierizmit. Në disa shkrime më parë e kam theksuar rolin tejte negativ të disa pjesëtarëve të, mendermethënë, shoqërisë civile pasi, si kurtizane profesioniste, u janë dorëzuar politikanëve, në shumë raste injorantë të dëshmuar, por të veshur me pushtet të paskajshëm. Janë për neveri ata pjesëtarë të shoqërisë civile që, edhe pas aderimit në subjekte politike dhe pasi arrijnë të kacavirren në majat e dëshiruara, nuk e shpeshin lidhjen me "bazën deleguese", qoftë si mundësi për rikthim në rast të dështimit, qoftë si burim paralel i mjeteve materiale ani pse në vendin ku punojnë marrin paga të majme, kryesisht të pamerrituara. Jemi dëshmitarë që pjesëtarë të shoqërisë civile që e luajnë rolin e mizave të kalit në prapicën e liderit politik, pas largimit, kryesisht si të dështuar nga "baza rekrutuese", flasin zi e terr për pronarin e grazhdit që i ka ushqyer deri në ditën e kiametit, ditën kur janë larguar, qoftë duke ua dhuruar një mirënjohje për punën e shkëlqyer, qoftë duke u qerasur me një shqelm në prapicë, me këpucë firmato të prodhuara në Kinë apo punëtoritë e Erdoganit. Pjesëtarët e shoqërisë civile që bëhen kondomë funksionale të shfave politikë, si biletë hyrëse dhe kërcënim ndaj politikanëve e përdorin mungesën e transparencës dhe llogaridhënies financiare dhe politike që kanë rëndësi dhe peshë për vendin. Për këtë kanë pasur përkrahjen e rezervë të bashkësisë ndërkombëtare dhe kërcënimi për transparencë dhe llogaridhënie ka qëndruar varur, si shpata e Demokleit mbi kokën e politikanëve, kryesisht të korrupuar dhe hajdutë ordinerë. Disa prej tyre nga gjykata kanë shkuar për bisedime në Bruksel. Me këto "vlera" të shoqërisë civile e ka çarë rrugën drejt majave të karrierës politike edhe Bekim Çollaku, personazhi negativ, por real i shkrimit tim të datës 5 qershor 2018. Bisedimet në Bruksel, të deklaruar si teknike, thembër të Akilit e kanë pasur pikërisht mungesën e transparencës dhe llogaridhënies të cilat janë zbatuar vetëm pasi kanë rrjedhur informatat në mediet elektronike dhe të shkruara, kryesisht nga pala serbe. Përfaqësuesit tanë kanë heshtur duke u arsyetuar se e kanë të ndaluar të deklarohen dhe se në emër të tyre flasin Kuperi, bashesha Ashton që paraqiste

rezik të madh për shëndetin e Thaçit gjatë përfaqësimit para dhe pas takimeve dhe tash, Frederika Mogerini. Vetëm pas kësaj, ish-kryeministri Thaçi, tash president, kanë raportuar para deputetëve të Kuvendit të Kosovës ndonëse nga Kuvendi kanë qenë të mandatuar të jenë transparentë për çdo marrëveshje të arritur me Beogradin. Këta bilbilat e ekipit negociues të Kosovës kanë vepruar në stilin napoletan apo të Sicilisë, e kanë zgjedhur omertën (ligjin e heshtjes) në komunikim me Kuvendin e Kosovës dhe deputetët e këtij Kuvendi që do të duhej t'i përfaqësonin dhe mbrojnë interesat e votuesve që i kanë votuar, por edhe qytetarëve të tjerë që nuk i kanë votuar. Deri vonë ka qenë mister zhdurka e anijeve, aeroplanëve dhe mjeteve të tjera në trekëndëshin e Bermudeve. Edhe bisedimet me Beogradin kanë funksionuar sikur sistemi i trekëndëshit të Bermudeve; kryeministri apo presidenti ministria për punë të jashtme dhe ministria për integritet eu(ropian) e që për qëllim ka pasur fshehjen apo zhdukjen e informatave për marrëveshjet e nënshkruara derisa të kalojë furtuna dhe të ketë një ngjarje që e mbulon të mëparshmen. Shihni se kush kanë qenë në krye të këtyre ministrive dhe do ta keni të qartë pse trekëndëshi i Brukselit për qytetarët e Kosovës ka qenë më i rrezikshëm dhe më i dëmshëm se trekëndëshi i Bermudeve. Bekim Çollaku ka qenë ministër i MiE dhe pasi ka mashtruar tërë kohë të mandatit qytetarët e Kosovës, është kthyer dhe ka kërkuar strehim institucional nën koçet e promotorit dhe sponsorit të tij politikë, presidentit aktual, zotëri Hashim Thaçi apo Shkëlqesia e ndryshkur, për fat të keq.
Po pse Bekimi personazh negativ ndonëse ka pamje moderne: Nëse më herët ka munguar transparenca, kohët e fundit ka ndryshime jashtëzakonisht pozitive në këtë drejtim. Presidenti Thaçi po deklaron botërisht se me Serbinë do të nënshkruajë një marrëveshje histo(rike) dhe se këtë e bën për të mirën e qytetarëve të Kosovës dhe ardhmërinë eu(ropiane) që e ka të garantuar brezi i shekullit të ri apo brezi pas viteve 2150 kur, as emri Hashim e as Behxhet nuk do të ekzistojnë sikur edhe veprat e tyre. Presidenti nuk lë mëdyshje se do të ketë kompromis në kohën kur çdo marrëveshje e nënshkruar ka qenë kompromis e që po e paguajmë edhe me prapicë. Me transparencën e deklaruar, Hashim Thaçi filloi të më dukej simpatik dhe parimor, prandaj edhe vendosa ta përkrahë botërisht sikur që po e bëjnë disa OJQ të vogla dhe OJQ-ja më e madhe në Kosovë e quajtur PDK. Tash do të fillojë përkrahja fushatë e padinjiteteshme për Hashimin, nga llaskuçet e dinjitetshëm. Zenun Pajaziti e përkrahi fort Hashimin si kryenegociator dhe në këtë

mënyrë seriozisht ma përkeqësoi gjendjen aktuale të hemorroideve. Një intervistë e Bekim Çollakut ku thotë se: "Do të bëjmë kompromis, por se askujt nuk do t'i tregojmë cili do të jetë ai..." seriozisht dhe përfundimisht ma luhati besimin te presidenti, nuk e di se kujt t'i besojë. Më kujtohet një barsolletë nga koha e studimeve për dy malazezë që e donin të njëjtën femër e që jetonin si fqinj. I pari, me emrin Vuk, kaloi me një vajzë të bukur dhe pasi e keqpërdor, ndahet nga ajo. Dragica, ish e dashura e Vukut, martohet për inat të Vukut me Njegoshin, i cili bën një dasmë të madhe për inat të Vukut. Edhe malazezët, sikur italianët e Sicilisë dhe dikur shqiptarët, e donin nusen e paprekur dhe kah mesnata, nëse nusja ishte e virgjër, në shenjë "krenarie" burrërore shtinin me pushkë, tri herë. Po atë natë Vuku, duke i bërë veshët katër, në orën 24.00 dëgjoi tri krisma pushke dhe, pak nën ndikimin e shlivovicës dhe emocioneve për të kaluarën me ish të dashurën, tash grua të Njegoshit, duke kruar kokën dhe duke fërkuar sytë mermëriti: "Zotin ta..., nuk e di a t'i besojë, pushkës së Njegoshit apo p....llës sime!". Edhe unë e kam të njëjtën dilemë, nuk e di a t'i besoj Hashimit apo Bekimit? Po të ishte kjo deklaratë çështje personale apo private e Bekim Çollakut, atëherë nuk do të kishim të drejtë të kërkojmë sqarim apo përgjegjësi sepse do të llogaritej si shkelje e privatësisë. Mirëpo, meqë kjo deklaratë ka të bëjë me të gjithë qytetarët e Kosovës, me çështje me rëndësi të jashtëzakonisht për Kosovën dhe me vetë ardhmërinë e Kosovës, kjo deklaratë është përqeshje dhe luftë koçe me qytetarët e Kosovës e që në rastet e shteteve normale do të lëvizte me shpejtësi të dritës prokurorinë e shtetit. Deklarata e Bekim Çollakut (nëse mediet e kanë transmetuar drejt e deri më tani nuk ka asnjë përgjeshtrim nga vetë Çollaku apo presidenti) nuk është e natyrës morale sepse hynë nën përgjegjësinë penale. Hashim Thaçi, nëse ka edhe vetëm 1 % të vullnetit ta respektojë transparencën dhe llogaridhënien, pas kësaj deklarate idioteske të njeriut numër 1 të kabinetit, me urgjencë duhet ta shkarkojë Bekim Çollakun dhe duhet ta thërrasë prokurorinë e shtetit të merret seriozisht me këtë deklaratë. Nëse Hashim Thaçi nuk ndërmerr asnjë masë ndaj tij, atëherë del se këtë e ka bërë me lejen e Hashimit dhe se vetë presidenca po përgatit plane konspirative që pariparueshëm do ta dëmtojë Kosovën dhe qytetarët e saj. Është e palejueshme dhe e dënueshme që klička e Bekimit që këtij vendi nuk i ka dhënë asgjë, por se e ka mbjellë me tërë potencialin që e ka, të vendosë për mua, familjen time dhe për të tjerët, pa na treguar se për çfarë bëhet fjalë. Këto deklarata nuk do t'i duronte

asnjë shtet normal e as qytetarët. Po të ndodhte, në një vend tjetër, që për çështje jashtëzakonisht të rëndësishme për vendin dhe qytetarët e saj të mbaheshin fshehtë kompromiset sikur që e bën ky farë Bekimi, reagimi qytetar do të ishte shumë i fuqishëm që do të përfundonte sigurisht me dorëheqje dhe, pa asnjë dyshim, me burgosje të personit publik që aq me paturpësi tallet me ndjenjat e qytetarëve dhe përgjegjësinë institucionale që e ka. Pas kësaj deklarate të Bekim Çollakut për kompromis të sigurt me Serbinë por, pa e treguar natyrën dhe peshën e kompromisit, një deputet që do ta votojë platformën qeveritare për bisedimet përfundimtare me Serbinë dhe Hashim Thaçin si kapo - kapelë të vetëm të këtyre bisedimeve, duhet jo ta dojë shumë Kosovën, por ta urrejë shumë në mënyrë që të bëhet pjesë e lojës së ndyrë, në kompromiset e ardhshme për të cilat nuk ka asnjë informatë, derisa të shpërthejë si kanalizimi me ujëra të zeza. Për këtë arsye jam i sigurt se pika ku do të diskutohet për platformën e bisedimeve dhe Hashim Thaçin si kryenegociator apo negociator i vetëm dhe të cilit ia miklon koçet Bekimi dhe bekimet e tjerë, nuk ka gjasa të kalojë dhe se të parët që duhet ta refuzojnë këtë platformë të bisedimeve, pas deklaratës çoroditëse të Bekim Çollakut, duhet të jenë deputetët e PDK-së. Duhet të mësohemi njëherë e mirë se për çështje me rëndësi të veçantë për shtetin dhe kombin nuk duhet dhe nuk mund të vendosë vetëm një njeri, qoftë ai edhe Shkëlqesia e Tij, presidenti i Republikës së Kosovës, zotëri Hashim Thaçi, e lere më fladitësi i koçeve të Hashimit, Bekim Çollaku. Serbia është e gatshme për kompromis me Kosovën sepse nuk ka kompromis ku Serbia do të ndahej humbëse. Serbia po tregton me tokën e Kosovës, me gjyqësorin e Kosovës, me arsimin e Kosovës, me shëndetësinë e Kosovës, me doganat e Kosovës, me financat e Kosovës, me kulturën e Kosovës, me sportin e Kosovës, me institucionet e Kosovës, me urat e Kosovës, me ujërat e Kosovës, me minierat e Kosovës, me ardhmërinë e Kosovës. Hajt të bisedojmë dhe të bëjmë kompromis për Kalemegdanin e Beogradit, për Vërmjaçak Banjën, për Jagodinën, fabrikën e duhanit në Nish, fabrikën e armaturës në Smederevë, fabrikën e armatimit në Kragujevc, për gjyqësorin e Serbisë, sportin e Serbisë dhe pasuritë nëntokësore dhe mbitokësore të Serbisë dhe të bëjmë kompromis. Nëse nga këto bisedime dhe kompromis fitojmë si Kosovë vetëm 1 %, ne do ta dalim fitues. Serbia, përmes marionetave të tipit Rakiq, nuk lë të hapet ura mbi lumin Ibër për të cilën ndërkombëtarët patën

caktuar afate dhe patën dhënë garanci se do të respektohen. Ku janë tash ndërkombëtarët dhe ku është Hasan Prishtina i Albin Kurtit, Agim Bahtiri i cili, nga frika prej Goran Rakiqit, nuk guxon ta kalojë urën edhe për t'i ujitur paçurkat. Serbet nuk e paguajnë rrymën dhe asnjë shërbim tjetër sepse nuk e njohin Kosovën, as si shtet e as si autoritet. Tash e kanë ndërprerë furnizimin me ujë nga liqeni i Ujmanit, për një pjesë të Vushtrrisë që e përdorin këtë sistem për ujitje dhe askush nuk ka guxim të veprojë institucionalisht. Kurse, më parë, me shoqërim policor ishin ndaluar disa fshatarë për kyçje ilegale dhe shfrytëzim pa leje të kanalit për ujitje Ibër - Lepenc. Serbet po e fusin në rend dite të bisedimeve në Bruksel çdo gjë që e pengon normalizimin e marrëdhënies dhe me qëllim të caktuar për të fituar kohë dhe që marrëveshja përfundimtare të jetë sa më e favorshme për ta. Tash, Zeznata Tahiri po deklaron se Zeveria e Kosovës, me grupin përgatitor njetnik (serbet) për statutin e Asociacionit të Komunave Serbe në Kosovë, seriozisht po e rrezikon Kosovën në kohën kur vetë ajo, me bisedimet "teknike" ka qenë pjesë shumë aktive e marrjes së vendimeve me pasoja të pariparueshme. Kjo farë mashtruese po flet si të ishte binjak me Bekimin. Tash Serbia duke shpikur tema dhe probleme të reja po grumbullon aq shumë favore e që nuk i takon as edhe një i vetëm për ditën D, kur Hashimi dhe Bekimi, Gjara dhe Gjura do të bëjnë kompromis e Kosova do të ndahet si humbëse absolute. Asociacioni i Komunave Serbe që do të deformohet sipas Marrëveshjes së Brukselit e jo sipas Gjykatës Kushtetuese do të jetë përcaktues për kompromis dhe do t'i udhëheqë resurset natyrore që do të kontrollohen nga ky monstrum juridik që përmbajtësisht dhe pariparueshëm e shkërdhënë pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës, me kompetencat ekzekutive që do t'i ketë! Më habitja pa masë pohimi i Enver Hasanit, të cilin e llogaris si një ndër kokat më të mençura shqiptare kur thotë se Asociacioni i Komunave Serbe po e përgatit një shtrat për autonomi territoriale. O Enver, por reagon me vonësë sepse serbet e "Kosovës" jo që kanë autonomi territoriale, por janë më të pavarur se vetë Kosova duke iu falënderuar kriminelit kushtetues, Marti Ahtisari dhe lakmitarëve kosovarë që nënshkruan çdo gjë, pa e lexuar fare dhe të cilët janë të veshur me tituj akademikë. Për këta injorantët politikë nuk vlen as të bisedohet sepse mund t'i ikin "drejtësisë tokësore", por jo edhe asaj qiellore, edhe përkundër bashkëpunimit me "nebski narod - populli qiellor". Kjo për momentin mund t'i çlirojë, kurse më vonë do t'i shtrëngojë, sikur darët e Maksimilian Robespjerit, e quajtur gjithnjë.

AMBASADORI I SHQIPËRISË NË MAQEDONI, FATOS REKA, VIZITON FIRMËN 'VATANI' NË GJILAN

Ismet SYLEJMANI

E diela e datës 3 qershor 2018 ishte nga më të veçantat në jetën time sepse kisha nderin dhe kënaqësinë të prisja në vizitë historike, në selinë qendrore në firmën time "Vatani" në Gjilan, ambasadorin fuqplotë të Shqipërisë në Maqedoni, mikun tim të nderuar, diplomatit shqiptar të karrierës, z. Fatos Reka, dhe diplomatit e ri që e shoqëronte ambasador Rekën, sekretarin e tretë të Ambasadës së Shqipërisë në Maqedoni, z. Alban Malia. Lufta heroike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e përkrahur edhe nga

përballuar me sukses misionin që na ishte ngarkuar mbi supë si gjeneratë, për ta bërë realitet ëndrrën e brezave, të udhëheqësve e ideologëve të mëdhenj të atdheut, që në tokat shqiptare të mos ketë pushtues të huaj! Prandaj, largimi i Serbisë pushtuese nga Kosova jo vetëm ka krijuar realitet të ri në Kosovë, por ka krijuar edhe një mundësi të madhe e të panjohur më parë në histori, atë të krijimit të relacioneve e raporteve të reja në mes të kombeve e shteteve, në mes të institucioneve e mekanizmave të ndryshëm, në mes të njerëzve e aspiratave të mëdha të tyre lirishtashëse që kanë bartur,



tribunin e kombit Ramiz Cernica dhe librin më të ri "Fjalime".

Me ambasador Rekën dhe diplomatit që e shoqëronte, mes të tjerash, biseduam për gjendjen në Maqedoni, në Kosovë e në Luginë të Preshevës dhe më gjerë!

U vlerësua se gjendja në Maqedoni është stabile dhe se populli shqiptar e partitë politike janë duke luajtur rol të rëndësishëm e pozitiv për të ardhmen euroatlantike të këtij vendi, i cili është me rëndësi të veçantë për paqen në Ballkan dhe stabilitetin në rajon.

Vizita e ambasadorit të Shqipërisë në Maqedoni, z. Fatos Reka, në selinë e firmës

"Vatani" në Gjilan, është dhe do të mbetet ngjarje historike për mua e firmën "Vatani", për familjen time, dhe për Gjilanin dhe Kosovën, sepse është bërë një vizitë që ka rikthyer vëmendjen e gjeneratave të vjetra dhe një paralajmërim të gjeneratave të reja, se realiteti i ri në Kosovë është madhështor, integruar dhe progresiv.

Kjo vizitë është edhe një dëshmi më shumë se nuk do të mund të realizohej sikur të mos ishte bërë lufta e armatosur e popullit shqiptar nën emblemat e shenjta të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare.

Prishtinë, 5. 6. 2018

Shqipëria, ShBA-ja, Anglia, Gjermania, Italia, Franca etj., jo vetëm ka larguar përgjithmonë Serbinë pushtuese nga Kosova, por ka krijuar realitet të ri i cili është krejtësisht i paimagjinuar e i rrallë në tokën shqiptare, por po dëshmohet katërcipërisht, se të jesh i lirë e i pavarur dhe i faktorizuar në rajon e më gjerë, është shumë domethënëse dhe progresive. Kontributi i madh historik e jetik i Shqipërisë në çlirimin e tokave shqiptare nga pushtuesi serb është përfundimisht vlera më e madhe kombëtare që na bën të ndihemi krenarë e të lumtur, që ora më e madhe e historisë na ka gjetur në këmbë e të mobilizuar, për ta

për të ecur vertikalisht e me dinjitet në jetë dhe për të krijuar vlera të reja për shoqërinë dhe njerëzimin.

Vizita e ambasadorit të Shqipërisë në Maqedoni, z. Fatos Reka, në selinë e firmës "Vatani", përpos që ishte ngjarje me rëndësi për mua dhe nderim e vlerësim për kontributin tim modest në të kaluarën në shërbim të çështjes kombëtare, ishte edhe inkurajim për të mos u ndalur së kontribuuar edhe në të ardhmen e për të shërbyer me devotshmëri kurdoherë që e kërkon atdheu.

Në shenjë respekti për vizitën e ambasadorit të Shqipërisë në Maqedoni, mikut të nderuar, z. Fatos Reka, ia dhurova dy librat e mi, atë për



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

CZECH REPUBLIC - NIGERIA

1

NORWAY - PANAMA

1

BELGIUM - EGYPT

1

Paraqitje e mirë e gjimnasteve në Itali

Paraqitja e katër gjimnasteve të Kosovës në Itali ishte e mirë, kurse më afër fitimit të medaljes ishte Vilëza Zeqiri, e cila është renditur e katërta në garën e kapërcimit. Bora Hoti, Amela Gërbeshi, Vilëza Zeqiri dhe Valëza Rama po parashikohen të jenë e ardhmja e gjimnastikës së Kosovës



"Epoka e re"

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Katër gjimnastet, Bora Hoti, Amela Gërbeshi, Vilëza Zeqiri dhe Valëza Rama, të udhëhequra nga trajneri Shkumbin Maqastena dhe trajnerja me përvojë ndërkombëtare Abelianë Bregu, janë kthyer të hënën në mbremje në Kosovë. Këto gjimnaste kanë marrë pjesë në "Gold Artistic Gymnastics Championship 2018" zhvilluar në Civitavecchia (RM) në Itali, kurse paraqitja e tyre ka qenë pozitive

për faktin se ishte hera e parë që merrnin pjesë në një aktivitet ndërkombëtar. "Pjesëmarrja ishte një sukses për klubin tonë, pasi ishte aktiviteti i parë jashtë vendit, edhe pse klub ynë i ka vetëm 1 vit e 6 muaj ushtrime. Pavarësisht prej pengesave dhe vështirësive të shumta që kemi pasur për të shkuar në këtë aktivitet, ne arritëm të jemi pjesë e tij, duke u përballur me emocione të reja dhe me një infrastrukturë olimpikë, e cila i mungon vendit tonë", thuhet në njoftimin e KGJ "Elita". Sipas njoftimit, paraqitja e

vashave në përgjithësi ishte e mirë, por emocionet, përshtatja me veglat gjimnastikore, mënyra e zhvillimit të aktivitetit, pati një ndikim te sportistet, duke bërë që ato të mos e japin maksimumin e tyre. "Gjimnastja që ishte më afër zonës së medaljes ishte Vilëza Zeqiri, e cila u rendit e katërta në kapërcime, pa harruar edhe Valezën, Borën, Amelën të cilat nderuan ngjyrat e flamurit të Kosovës, njëkohësisht ato janë tepër premtuese për të ardhmen e sportit të gjimnastikës", thuhet në njoftimin e Klubit "Elita" nga Prishtina.

SHKURT

Kukësi transferon Faton Malokun

Faton Maloku do të jetë pjesë zyrtare e Kukësit për sezonin e ri 2018-2019. Portieri i Kombëtares së Kosovës ka firmosur për verilindorët. 27-vjeçari konsiderohet një alternativë e mirë për portën dhe me këtë lëvizje duket se marrëdhëniet me Enea Koliçin nuk janë më të mirat. Pakult është bindur nga portieri kosovar dhe me shumë gjasa ai do të jetë portieri titullar i Kukësit. Maloku këtë sezon ka mbrojtur portën e Feronikelit.

Ballkani prezanton Shabanin

Skuadra e Ballkanit po vazhdon të bëjë transferime në këtë afat kalimtar. Klubi nga Theranda e prezantoi Egzon Shabanin, i cili ka përvojë të madhe në elitë. Kjo skuadër që këtë edicion do të bëjë gara në Superligë, ka transferuar edhe Besnik Krasniqin dhe Leart Eminin.

Zavalovi, fitues i "Tour de Kosova"

Holandezi Inokenti Zavalov i klubit WV Breda e ka fituar edicionin e 18 të "Tour de Kosova". Pas tij i dyti në konkurrencën individuale ka dalë Daaf Koemans, ndërsa i treti Bart Dielissen, që të tre nga klubi holandez WV Breda. Për 4 ditë, ciklistët nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Bullgaria dhe Holanda kanë kaluar rreth 600 km në katër etapa. Holandezët u ndanë jashtëzakonisht të kënaqur dhe të impresionuar nga vizita e tyre e parë në Kosovë.

Berisha, afër Sampdorias

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Valon Berisha, pritet të transferohet në Serinë A. Lajmin e ka bërë me dije Gianluca di Marzio, i cili parashikon se lojtari i Salzburgut do t'i bashkohet Sampdorias. 25-vjeçari është paraqitur në dhjetë ndeshje për Kosovën dhe ka shënuar një gol.

Kosova, dy ndeshje miqësore kundër Maqedonisë

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Përfaqësuesja e femrave në futboll do t'i luajë dy ndeshje miqësore me përfaqësuesen e Maqedonisë. Dy ndeshjet do të zhvillohen gjatë javës së ardhshme në stadiumin "Adem Jashari" në Mitrovicë. Takimi i parë nis më 12 në orën 17:00, kurse i dyti më 14 qershor me fillim nga ora 12:00. "Krahas

grumbullimeve të meshkujve, FFK-ja rëndësi të veçantë po i kushton edhe Kombëtares A të femrave. Kështu siç bën të ditur drejtori për marrëdhënie me jashtë dhe i ekipeve kombëtare, Artan Govori, kombëtarja A e femrave do të grumbullohet nga data 10 qershor, pasi është arritur pajtueshmëri me Federatën e

Futbollit të Maqedonisë, që të zhvillohen dy ndeshje miqësore me Kombëtaren e Maqedonisë. Me qëllim të zhvillimit të futbollit të femrave, FFK-ja do të vazhdojë të bëjë grumbullime të tjera dhe do të organizojë ndeshje miqësore me rivalë të tjerë", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK).





MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, L. nr. 03/L-149, Rregulloren Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Titulli i punës: Vozites

Institucioni: MKRS-Prizren

Kategoria funksionale : Koeficienti: 7

Numri i referencës: 30/2018

I përgjigjet: Udhëheqësit të Divizionit për Teknologji të Informacionit dhe Shërbimeve Logjistike

Vendi: Prizren

Lloji i kontratës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (Kohëzgjatja 6 muaj).

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, përbushë detyrat dhe përgjegjësitë e poshtëshënuara:

1. Ofron transport sipas nevojave të stafit të administratës së MKRS-se;
2. Sipas nevojës, ofron transport për të ftuarit e Ministrisë;
3. Bënë kontrollimin elementar teknik në mënyrë të kohëpaskohshme, të veturave të Ministrisë;
4. Shpërndan dokumentet nga MKRS në institucione tjera;
5. Kujdeset për mirëmbajtjen e veturave dhe pastërtinë e tyre;
6. Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së shefit të logjistikës.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Diplome e Shkollimit të Mesëm;
2. Së paku 1(një)vit, përvojë pune;
3. Aftësi të mjaftueshme që herë pas here, të merret me disa çështje , të cilat nuk janë parapare në udhëzime, por që lidhen me nevojat e institucionit;
4. Aftësi të mira komunikuese, me punonjësit tjerë të njëjtit nivel, në njësinë organizative brenda institucionit, ose me persona të tjerë , me qëllim të shkëmbimit të informatave;
5. Të jetë energjik, të ketë shkathtësi të mira ndërnjerëzore dhe të jetë i gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës.

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të caktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur tete (8) ditë pas ditës së shpalljes.

Data e fundit e aplikimit është: 13.06.2018

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Tereza" nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211449 , (apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org>.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazirajući se na Zakon o Civilnim Uslugama Republike Kosova, Z. br. 03/L-149, Pravilnik br. 02/2010, o Procedurama za Rekrutovanje u Civilnim Uslugama Republike Kosova, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta objavljuje:

KONKURS

I

Naziv rada: Šofer

Institucioni: MKOS-Prizren

Funkcionalna kategorija : Koeficientat: 7

Numri i referencës: 30/2018

Odgovorani je: Rukovodiocu Divizije za Tehnologiju Informacije i Usluge Logistike

Mesto: Prizren

Vrsta ugovora: Sporazum o posebnim Uslugama (Vremensko trajanje 6 meseci).

Zadaci i odgovornosti: Po nadzorom , Rukovodioca Divizije za Tehnologiju Informacije i Usluge Logistike ispunjava dole navedene zadatke i odgovornosti:

1. Nudi transport prema potrebama stafa i administracije MKOS-sa;
2. Prema potrebi, nudi transport za pozvane u Ministarstvu;
3. Vršiti elementarnu tehničku kontrolu, s vremena na vreme za vozila Ministarstva;
4. Raspodeljuje dokumenta iz MKOS-a u ostale institucije;
5. Bri o održavanju vozila i njihovu čistoću;
6. Izvršava i ostale poslove prema zahtevu šefa logistike.

Zahtevano obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike:

1. Diploma Srednje Obrazovanja;
2. Najmanje 1(jedna)godina iskustva;
3. Dovoljne sposobnosti da se, s vremena na vreme, zauzima pitanjima koja nisu predviđena u uputstvima ali, koja su povezana potrebama institucije;
4. Dobre sposobnosti u komuniciranju sa ostalim radnicima istog nivoa u istoj organizativnoj jedinici unuta institucije ili, sa ostalim osobama, u cilju razmene informacija;
5. Da je energičan, da ima dobre međuljudske sposobnosti i da je spreman da radi sa fleksibilnim radnim vremenom.

Procedura konkurisanja: Konkurs je otvoren za sve kandidate.

Vremensko trajanje imenovanja: Imenovanje je na određeno vreme.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs je otvoren osam (8) dana, nakon dana objavljivanja.

Zadnji datum za aplikovanje je: 13.06.2018

Aplikacije poslate preko pošte, sa poštanskom markicom, na zadnji dan objave, smatraće se validnim.

Podnošenje zahteva: Aplikacija se uzima i predaje u kancelariji br. 27 Ministarstva Kulture, Omladine i Sporta, Trg "Majka Tereza" br. 44. Za dodatne informacije kontaktirajte broj 038211449 , (ili web-stranicu <http://www.mkrs-ks.org>.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and
Industry

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/ L -149, Rregullore Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë bën:

REKRUTIM

Institucioni: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Inspektorati i tregut

Divizionit për cilësi dhe tregtinë e naftës dhe derivateve të naftës

Titulli i vendit të punës: Inspektor i tregut

Koeficienti / 7

Nr. i Referencës: MTI/ 5

Numri i zyrtarëve që do të pranohen: 2

Vendi: Prishtinë

Datë: 06.06.2018

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zhvilloni dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e projekteve, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën profesionale specifike;
- Kryen detyra e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikën dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
- Mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për tregti me naftë dhe derivateve të naftës, akteve nënligjore, si dhe marrjen e masave administrative dhe masave tjera;
- Merr pjesë në grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë;
- Bën mostrim, testim, analiza, vlerësim të rezultateve dhe në fund bën arkivim të mostrave, rezultateve të derivateve të lëngëta të naftës;
- Bën monitorimin dhe kontrollimin e cilësisë së naftës në tregun e Kosovës;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;

Kualifikimet për këtë vend të punës:

- Diplomë universitare: FSHMN, Juridik, Ekonomik;
- Minimum 3 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel);

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Kohëzgjatja e emërimit:

Nëpunësi i karricës (përhershëm) Periudha provuese. Dymbëdhjetë (12) muaj.

Data e mbylljes së konkursit:

20.06.2018

Paraqitja e kërkesave

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MTI-së, ose të tërhiqen nga web faqja e MTI-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit, në adresën www.mti-ks.org dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, çdo ditë pune nga ora 8:00 -16:00 deri më: **20.06.2018**. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

"Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcionalitet organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"

Kërkesat e pakompletuara si dhe kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and
Industry

U skladu sa odredbama Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosovo, Zakon Br. 03/L -149, Pravilnik Br. 02/2010 o Procedurama Rekrutacije u Civilnoj Službi Republike Kosova i Pravilnika Br. 21/2012 za Napredovanje u Karijeri Civilnih Službenika, Ministarstvo Trgovine i Industrije obavlja:

REGRUTOVANJE

Institucija: Ministarstvo Trgovine i Industrije

Tržišna Inspekcija

Sektor za kvalitet i trgovinu nafte i naftnih derivata

Naziv radnog mesta: Tržišni inspektor

Koeficijent / 7

Referentni br: MTI/ 5

Broj službenika: 2

Mesto: Priština

Datum: 06.06.2018

Obaveze i odgovornosti:

- Razvija i postiže saglasnost za radne planove i rokove, u koordinaciji sa nadzornikom, za implementaciju relevantnih projekata, usluga i proizvoda u specifičnom stručnom oblasti;
- Izvršava obavezno predviđene planovima rada usvojenim u skladu sa dotičnim zakonima, propisima, politikama i procedurama, u određenim vremenskim rokovima;
- Nadgleda primenu Zakona o trgovini naftom i naftnih derivata, podzakonskim aktima, kao i preduzimanje administrativnih i drugih mera;
- Učestvuje u radnim grupama u specifičnoj stručnoj oblasti kada se to zahteva;
- Izvršava uzorkovanje, testiranje, analizu, procenu rezultata i konačno arhivira uzorke, rezultate tačnih naftnih derivata;
- Monitorira i kontroliše kvalitet nafte na tržištu Kosova;
- Obavlja i sve druge obavezno u specifičnoj profesionalnoj oblasti u skladu sa važećim zakonima i propisima, koje se razumno mogu povremeno zahtevati.

Kvalifikacije za ovo radno mesto:

- Univerzitetska Diploma: FPMN, Pravni, Ekonomski Fakultet;
- Minimum 3 godine radnog iskustva u struci;
- Duboko i specijalizovano znanje u specifičnom stručnom polju stečeno kroz visoko obrazovanje i odgovarajuću obuku;
- Poznavanje primenljivih zakona i propisa;
- Veštine u komunikaciji, planiranju i vođenju tima;
- Istraživačke, analitičke i ocenjivačke veštine i formulisanje stručnih preporuka i saveta;
- Kompjuterske veštine u softverskim aplikacijama (Word, Excel);

Uslovi učesća u regrutovanju:

